



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1421/5 Prot.

Tiranë, më 26.05.2023

VENDIM  
Nr. 58 datë 26.05.2023  
PËR

**NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES NË KUADËR TË PROGRAMIT  
ERASMUS+ PËR MOBILITETIN E STAFIT DHE STUDENTËVE ME  
UNIVERSITETIN E ROMËS "FORO ITALICO", ITALI**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', neni 3, pika 4, gërma "c" si dhe në Statutin e Universitetin të Sporteve të Tiranës neni 20, pika "s", Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 26/05/2023,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes në kuadër të Programit ERASMUS+ për mobilitetin e stafit dhe studentëve me Universitetin e Romës "Foro Italico", Itali.
2. Ky vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**KRYETAR I SENATIT**

**Prof.Dr. AGRON KASA**

